



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Tiranë, më datë 21.06.2022

Nr. 715 Prot.

VENDIM
Nr. 275, datë 21.06.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknikë dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 21.06.2022:

VENDOSI:

1. Shtyrje vendimmarje për projektin “Restaurim dhe rijetësim i Banesës Belaj”, Gjirokastrë, Monument Kulture Kategori I, me aplikues dhe zhvillues Mehmet Belaj;
 - Të detajohet projekti teknik me gjendjen aktuale, si dhe me propozimet përkatëse të Monumentit në të gjithë komponentët e tij (në interior dhe eksterier);
 - Propozimet e ndërhyrjeve të mos çënojnë vlerat arkitektonike dhe artisitike të objektit pasuri kulturore;
 - Të sillen saktësime si do të kryhen ndërhyrjet restauruese në çati dhe në oborr të banesës, në raport me të gjithë planin e çatisë së Monumentit;
 - Të plotësohet dokumentacioni ligjor me dokumentin që vërteton statusin juridik të pronës.
2. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknikë për njoftimin e këtij Vendimi;

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

KRYETAR
Elva MARGARITI

